

Raport i praktikave të mira mbi kompostimin organik



Tetor 2024

Raport i praktikave të mira mbi kompostimin organik

Tetor 2024

Autori: Ermira Kurti - Menaxhere programi Help në Shqipëri

Redaktoi: Nadjuska Çela - Oficere projekti Help në Shqipëri

Përgatiti për botim dhe dizajni: Besnik Hoxha - Oficer projekti Help në Shqipëri

Ky botim është hartuar në kuadër të projektit “Shtirirje e skemës së kompostimit organik në komunitetet rurale” bashkëfinancuar nga Agjencia Sllovake për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim dhe zbatuar nga Help në Shqipëri. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e SlovakAid.

© **Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra për Shqipërinë**

Kompleksi Kika 2, Rruga Tish Daija, Nd. 1C9, H.9, Ap.7A, 1020 Tiranë - Shqipëri

Email: info-alb@help-ev.de

Cel: +355 69 572 6762

Website: www.help-albania.org

Facebook: Help in Albania

Instagram: Help in Albania

LinkedIn: Help in Albania



Përmbajtja

1. Hyrje dhe parathënie	f. 3
2. Kompostimi organik dhe rëndësia e tij	f. 4
◦ Përfitimet ekonomike	
◦ Përfitimet shoqërore	
◦ Përfitimet mjedisore	
3. Modelet e kompostimit në komunitet	f. 11
◦ Kompostimi në vendbanime	
◦ Kompostimi në komunitet	
◦ Kompostimi në biznese dhe institucione	
4. Barrierat në kompostimin organik	f. 15
◦ Mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit	
◦ Infrastruktura e pamjaftueshme	
◦ Shqetësimet mbi erën dhe higjienën	
◦ Pengesa financiare	
◦ Mungesa e mbështetjes politike dhe ligjore	
5. Mësimet e nxjerra nga kompostimi në komunitet	f. 21
◦ Edukimi dhe ndërgjegjësimi	
◦ Mbështetja nga liderët lokalë dhe organizatat	
◦ Përfshirja e komunitetit	
◦ Monitorimi dhe përmirësimi i procesit	
6. Praktikat e mira të kompostimit organik	f. 25
◦ Përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit	
◦ Trajnim praktik dhe demonstrime	
◦ Edukimi në shkollë dhe përfshirja e fëmijëve	
◦ Monitorimi afatgjatë dhe mbështetja pas projektit	
7. Histori suksesi nga zbatimi i projektit në Shqipëri	f. 24
◦ Përvoja e komuniteteve në Bërzhitë dhe Zall-Herr	
◦ Fuqizimi i grave dhe roli i tyre në kompostim	
◦ Përpjekjet kolektive të komunitetit	
8. Përfundime dhe Rekomandime	f. 27
9. Referenca	f. 28

Parathënie

Në një kohë kur mbrojtja e mjedisit dhe qëndrueshmëria janë më të rëndësishme se kurrë, praktikatat inovative për menaxhimin e mbetjeve organike janë thelbësore. Ky raport synon të ofrojë një udhëzues të hollësishëm për kompostimin organik në komunitet, duke mbledhur përvojat dhe mësimet e nxjerra nga projekte të suksesshme në zona rurale dhe urbane.

Kompostimi organik është një metodë e thjeshtë, por me ndikim të madh, që shndërron mbetjet organike në burime të vlefshme për tokën. Përfitimet e tij përfshijnë reduktimin e mbetjeve të dërguara në landfill, përmirësimin e cilësisë së tokës dhe krijimin e mundësive për prodhim lokal më të shëndetshëm. Përmes përfshirjes së komunitetit dhe mbështetjes institucionale, kjo praktikë ka treguar rezultate të jashtëzakonshme në rritjen e ndërgjegjësimit për mjedisin dhe në nxitjen e ekonomisë lokale.

Raporti përshkruan gjithashtu shembuj konkretë të zbatimit të kompostimit organik në komunitetet e njësive administrative Bërzhitë dhe Zall-Herr, duke treguar sesi bashkëpunimi dhe edukimi i vazhdueshëm kanë krijuar një kulturë të re qëndrueshmërie. Ky publikim është një burim i vlefshëm për çdo individ, organizatë apo institucion që kërkon të përmirësojë praktikatat e menaxhimit të mbetjeve dhe të kontribuojë në një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm.

Shpresojmë që ky raport t'ju frymëzojë të bëheni pjesë e ndryshimit pozitiv dhe të përqafoni kompostimin si një hap të rëndësishëm drejt qëndrueshmërisë së komunitetit tuaj.



Kompostimi organik

Kompostimi organik në komunitet është një praktikë shumë e rëndësishme për menaxhimin e mbetjeve organike dhe promovimin e qëndrueshmërisë. Ky proces përfshin grumbullimin e materialeve organike, si mbetjet e ushqimit, gjethet dhe barin etj, e transformimin e tyre në një pleh natyror që mund të përdoret për të fertilizuar token. Ky proces jo vetëm që redukton mbeturinat e dërguara në landfill, por edhe prodhon një burim të vlefshëm për përmirësimin e cilësisë së tokës, hapësira më të gjelbra, siguri të shtuar ushqimore dhe rritje të njohurive dhe aftësive të anëtarëve të komunitetit për kompostim organik.



Rëndësia e kompostimit organik

Rëndësia e kompostimit organik është rritur ndjeshëm në ndërgjegjen e komunitetit në vitet e fundit, kjo pasi është një nga metodat më miqësore ndaj mjedisit, dhe një mënyrë e sigurt për t'i bërë kopshtet tona të lulëzojnë dhe prodhimet tona të rriten shëndetshëm. Kompostimi është një mënyrë e thjeshtë dhe e lirë për të krijuar lëndë ushqyese dhe pleh për kopshtet. Gjithashtu, është mënyra më e shpejtë për të hequr mbeturinat që gjenerohen çdo ditë në kuzhinë, gjethet dhe mbetjet e tjera organike të grumbulluara në kopshte të cilat çdo ditë duhet t'i fshijmë dhe hedhim jashtë oborreve tona.

Përfitimet e kompostimit organik në komunitet janë shumë të rëndësishme dhe përfshijnë aspekte:

Mjedisore

- Reduktimi i mbetjeve
- Fertilizimi natyror
- Përmirësimi i tokës
- Mbrojtja e mjedisit

Shoqërore

- Edukimi dhe ndërgjegjësimi
- Rritja e ndërveprimit në komunitet

Ekonomike

- Kursime ekonomike
- Mbështetje për prodhimin lokal të ushqimit

Aspekti Mjedisor

Reduktimi i mbetjeve.

Kompostimi i mbetjeve organike si mbetjet e ushqimit, lëkurat e frutave, perimeve etj ndihmon në uljen e sasisë së mbetjeve që përfundojnë në landfill, duke kontribuar jo vetëm në menaxhimin më të mirë të mbetjeve por edhe duke minimizuar shpërdorimin e burimeve.

Fertilizimi natyror.

Fertilizimi natyror përmes kompostimit organik është një praktikë shumë efektive dhe e qëndrueshme për përmirësimin e tokës dhe rritjen e bimëve. Komposti përmban azot, fosfor, kalium dhe mikroelementë të tjerë që janë të nevojshëm për zhvillimin e shëndetshëm të bimëve. Si i tillë, ai stimulon aktivitetin e mikroorganizmave të dobishëm në tokë, të cilët ndihmojnë në shpërbërjen e materieve organike dhe në përthithjen e ushqyesve nga bimët. Gjithashtu, duke përdorur kompostin si fertilizues, zvogëlohet nevoja për pesticide dhe plehra kimike si dhe në të njëjtën kohë kontribuohet në ruajtjen e burimeve natyrore duke reduktuar në këtë mënyrë mbeturinat përmes riciklimit të materialeve organike.

Përmirësimi i tokës.

Përmirësimi i tokës përmes kompostimit organik është një praktikë shumë efektive për të rritur fertilitetin dhe shëndetin e tokës. Komposti ndihmon në krijimin e një strukture më të mirë të tokës, duke rritur kapacitetin e saj për të mbajtur ujë dhe ajër. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për tokat e ngjeshura ose me shumë argjilë. Komposti ndihmon në rritjen e kapacitetit të tokës për të mbajtur lagështirë, duke reduktuar nevojën për ujitje të shpeshtë. Nga ana tjetër, një tokë e pasur me kompost është më rezistente ndaj erozionit, duke ndihmuar në ruajtjen e sipërfaqes së saj dhe duke parandaluar humbjen e lëndëve ushqyese. Në disa raste, komposti mund të ndihmojë në rregullimin e nivelit të aciditetit të tokës, duke e bërë atë më të përshtatshme për rritjen e bimëve, si dhe ndihmon në krijimin e një ekosistemi më të shëndetshëm, duke mbështetur jetën e insekteve, mikrobeve dhe organizmave të tjerë të dobishëm në tokë.

“Me kompostimin, toka është më e shëndetshme dhe prodhimet e mia kanë shije më të mirë.”

- Pranvera, një nga përfitueset e projektit



Mbrojtja e mjedisit.

Kompostimi organik është një metodë e thjeshtë dhe efektive për mbrojtjen e mjedisit. Ai përfshin procesin natyral të dekompozimit të materialeve organike si mbeturinat e kuzhinës, gjethet, barin e prerë dhe materialet e tjera bimore, për t'i kthyer ato në pleh të pasur në lëndë ushqyese, të njohur si humus. Kompostimi organik zvogëlon sasinë e mbeturinave që përfundojnë në landfille, ku ato shpesh çlirojnë metan, një gaz serë i dëmshëm si dhe lëngje të tjera toksike që mund të ndotin ujin dhe ajrin. Kompostimi në burim jo vetëm që parandalon këtë ndotje por zvogëlon gjithashtu edhe nevojën e fermerëve dhe kopshtarëve për plehra kimike, të cilët shpesh shkaktojnë edhe ato ndotje të ujërave dhe degradim të tokës.

Aspekti Shoqëror

Edukimi dhe ndërgjegjësimi.

Kompostimi ka një rol të rëndësishëm në edukimin e komunitetit, duke ofruar mundësi për të mësuar mbi praktikën e qëndrueshme dhe menaxhimin e mbetjeve në mënyrë praktike dhe të prekshme. Ja si ndikon ky proces në edukimin e anëtarëve të komunitetit:

- *Rritja e ndërgjegjësimit për riciklimin natyror.* Kompostimi është një shembull i riciklimit natyror, ku mbetjet organike kthehen në pleh për tokën. Duke u angazhuar në kompostim, komuniteti mëson se si mund të përdoren mbetjet në një mënyrë të dobishme.
- *Nxitja e zhvillimit të njohurive për ekonominë qarkulluese.* Kompostimi e vendos vëmendjen tek ekonomia qarkulluese, duke e treguar materialin organik si një burim që mund të rihyjë në ciklin e natyrës.
- *Krijimi i një platforme për diskutim dhe nisma bashkëpunuese.* Projekte të përbashkëta të kompostimit krijojnë hapësira për diskutim dhe ndarje të njohurive, ku pjesëtarët e komunitetit mësojnë nga përvojat e njëri-tjetrit mbi praktikën e mira të menaxhimit të mbetjeve.
- *Përfitimi për tokën dhe natyrën si shembull praktik.* Pasi procesi i kompostimit përfundon, komuniteti përjeton drejtpërdrejtë përfitimet e qëndrueshmërisë. Kështu mbetjet kthehen në burim ushqimi për tokën, ku pjesëtarët e komunitetit përvetësojnë idenë se praktikën e qëndrueshme kanë përfitime të prekshme për natyrën dhe jetën e përditshme.

“Mbetjet organike në landfill mund të shkaktojnë helme që do sillnin edhe më shumë ndotje për mjedisin”.

- Mondì, një nga përfituesit e projektit



Rritja e ndërveprimit në komunitet.

Nismat e kompostimit organik kanë një ndikim të rëndësishëm në nxitjen e bashkëpunimit midis banorëve, duke forcuar lidhjet sociale, ndërtuar marrëdhënie të forta dhe duke krijuar një ndjenjë të thelluar të përkatësisë në komunitet. Ja si realizohet kjo:

- *Krijimi i projekteve të përbashkëta komunitare.* Nismat e kompostimit organik shpesh organizohen në mënyrë të përbashkët, si në kopshte, shkolla apo hapësira publike. Ky angazhim për krijimin e një sistemi kompostimi lokal nxit anëtarët e komunitetit të punojnë së bashku për një qëllim të përbashkët, çka forcon ndjenjën e bashkëpunimit dhe të ndihmës së ndërsjellë.
- *Ndërtimi i një ndjenje përgjegjësie kolektive.* Kur banorët punojnë së bashku për të menaxhuar mbetjet organike, ata krijojnë një ndjenjë përgjegjësie për mjedisin dhe për komunitetin e tyre. Ky përkushtim ndaj mbrojtjes së mjedisit i bashkon njerëzit, duke i bërë ata të ndihen të lidhur dhe pjesë e një përpjekjeje më të madhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së përbashkët.
- *Përmirësimi i mjedisit përmes bashkëpunimit.* Kur njerëzit angazhohen në përmirësimin e zonave të përbashkëta përmes kompostimit, ata krijojnë një mjedis më të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë. Ky proces krijon një ndjenjë të përkatësisë dhe të krenarisë për zonën ku jetojnë, duke i bërë banorët më të lidhur me vendin dhe me njëri-tjetrin.
- *Përfshirja në evente dhe aktivitetet e komunitetit.* Eventet si "Dita e Tokës" apo sesionet mujore të grumbullimit të mbetjeve organike krijojnë një atmosferë festive dhe bashkëpunuese. Të tilla aktivitete forcojnë lidhjet sociale duke krijuar një ndjenjë të përbashkët të përkatësisë dhe të angazhimit për qëllime të përbashkëta.
- *Angazhimi i brezave të ndryshëm dhe pjesëmarrja ndër-brezore.* Kompostimi është një praktikë që lejon pjesëmarrjen e të gjitha moshave në kryerjen e procesit. Kur të rinjtë dhe të moshuarit punojnë së bashku për të kompostuar, krijohet një hapësirë ku brezave të ndryshëm u jepet mundësia të bashkëpunojnë, të krijojnë lidhje dhe të ndajnë përvojat dhe njohuritë e tyre.

"Kompostimi më ka ndihmuar të përmirësoj cilësinë e bahçes dhe të ofroj produkte më të mira për blerësit."

Valentina, një nga përfitueset e projektit



Aspekti ekonomik

Kursime ekonomike.

Kompostimi organik jo vetëm që ndihmon në mbrojtjen e mjedisit, por gjithashtu sjell përfitime ekonomike për individët dhe komunitetet. Disa prej përfitimeve ekonomike kryesore përmes kompostimit organik përfshijnë:

- *Ulja e shpenzimeve për plehra kimike.* Komposti është një zëvendësues i plehrave kimike. Duke përdorur kompost për të pasuruar tokën me lëndë ushqyese, fermerët mund të kursejnë paratë që do t'u duheshin që t'i shpenzonin për plehra kimike të shtrenjta.
- *Ulja e tarifave të mbeturinave.* Shumë bashki ose struktura shtetërore vendore kanë taksa dhe tarifa të ndryshme për mbeturinat bazuar në sasinë e dërguar në landfill. Duke kompostuar mbeturinat organike në vend që të dërgohen në landfill mund të zvogëlohen sasi të mbeturinave të gjeneruara dhe, si pasojë, të ulen kostot e menaxhimit të mbeturinave, përfshirë tarifat e shërbimeve publike për këtë qëllim.
- *Kursime në ujin për vaditje.* Komposti organik ndihmon tokën të mbajë më mirë ujin, duke reduktuar nevojën për vaditje të shpeshtë. Kjo mund të përkthehet në kursime të ndjeshme të kostos së ujit, sidomos në ato zona ku vaditja për kultivim është e nevojshme dhe ku uji është një burim i kufizuar.
- *Krijimi i mundësive për të ardhura të reja.* Për bizneset ose komunitetet që prodhojnë sasi të mëdha komposti, mund të krijohen mundësi për të shitur produktin si pleh organik. Kjo mund të kthehet në një burim të ardhurash për fermerët, kopshtarët dhe projektet e kompostimit në një shkallë më të gjerë.
- *Reduktimi i shpenzimeve të energjisë.* Kur materialet organike trajtohen në landfill, ato prodhojnë metan, një gaz serë që kërkon energji për t'u menaxhuar. Përmes kompostimit, zvogëlohet nevoja për trajtime të energjisë intensive në landfill apo inceneratorë, duke kursyer burimet energjetike dhe kostot përkatëse.
- *Zgjatja e jetës së landfilleve.* Duke reduktuar sasinë e mbeturinave organike të dërguara në landfill, kompostimi i këtyre mbetjeve kontribuon në zgjatjen e jetëgjatësisë së landfilleve dhe inceneratorëve, duke shmangur shpenzimet e mëdha për hapjen e landfilleve të reja apo mirëmbajtjen e atyre ekzistuese.

“Kam një ullishte të vogël, dhe shpesh më duhej të shpenzoja shumë për plehra. Kompostimi më ka ndihmuar të përmirësoj tokën natyrshëm dhe të ul shpenzimet.”

Artani, një nga përfituesit e projektit



Mbështetje për prodhimin lokal të ushqimit.

Kompostimi mund të ndihmojë në zhvillimin e kopshteve komunitarë lokale dhe projekteve të tjera bujqësore, duke rritur aksesin në ushqim të freskët dhe të shëndetshëm. Kjo bën që kompostimi organik të jetë një praktikë tërheqëse për komunitetet që dëshirojnë të promovojnë qëndrueshmërinë dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës. Më poshtë janë disa mënyra sesi kompostimi organik mbështet prodhimin lokal të ushqimit:

- *Përmirësimi i cilësisë së tokës dhe prodhimit.* Komposti i bërë nga mbetjet lokale organike siguron një burim të qëndrueshëm dhe natyral të plehrave për prodhuesit lokalë të ushqimit. Kjo ndihmon fermerët të përmirësojnë cilësinë dhe sasinë e produkteve të tyre.
- *Reduktimi i kostove të inputeve bujqësore.* Komposti organik prodhohet në vend dhe nuk importohet nga jashtë, duke reduktuar shpenzimet për plehra, gjë që mund të çojë në çmime më të përbalueshme për konsumatorët lokalë.
- *Zvogëlimi i ndotjes.* Përdorimi i kompostit organik zvogëlon nevojën për plehra dhe pesticide kimike, të cilat mund të ndotin tokën, ujin dhe ajrin. Duke mbështetur prodhimin lokal të ushqimit përmes kompostimit, promovohen praktika të bujqësisë së pastër që mbrojnë ekosistemet dhe ulin ndikimin negativ në mjedis.
- *Rritja e aksesit në ushqim të freskët dhe të shëndetshëm.* Mbështetja e prodhimeve lokale përmes kompostimit ndihmon që produktet e freskëta dhe organike të jenë më të aksesueshme për komunitetin.
- *Nxitja e ekonomisë lokale dhe vetë-mjaftueshmërisë.* Përmes kompostimit organik, komunitetet mund të bëhen më të vetë-mjaftueshme në prodhimtari, duke reduktuar varësinë nga importet e ushqimeve dhe inputeve bujqësore. Kjo mund të nxisë rritjen ekonomike lokale, të krijojë vende pune në bujqësi dhe industri të lidhura, dhe të mbështesë krijimin e një ekonomie të qëndrueshme e cila bazohet në kompostimin organik.

"Me koshin e kompostimit, gjithçka që dikur e konsideroja mbetje është kthyer në një burim të vlefshëm për fermën time."

Mehdiu, një nga përfituesit e projektit





Llojet e modeleve të kompostimit në komunitet

Kompostimi organik në komunitetet është një zgjidhje efektive dhe e qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave organike, që gjithashtu sjell përfitime mjedisore dhe ekonomike për komunitetet urbane dhe rurale. Në vazhdim, janë disa nga modelet e kompostimit në komunitet të cilat do ti trajtojmë dhe në vijim.



Kompostimi në vendbanime



Kompostimi në komunitet



Kompostimi në biznese dhe institucione

Kompostimi në vendbanime

Ky model nxit kompostimin individual në shtëpi, ku familjet përdorin kontejnerë të vegjël ose gropa për dekompozimin e mbetjeve organike si lëvozhgat e perimeve, barërat dhe mbetjet e kopshtit. Kjo metodë është e përshtatshme si për zona urbane ashtu edhe për ato rurale. Në zonat urbane mund të zbatohet në hapësira të kufizuara, si ballkone, tarraca apo kopshtet urbane. Kjo lejon banorët e zonave urbane të riciklojnë mbeturinat e kuzhinës dhe kopshtit dhe të përdorin kompostin për bimët e tyre. Ndërkohë zonat rurale shpesh kanë më shumë hapësira për të zhvilluar kompostim në shkallë më të gjerë, duke përfutur nga mbeturinat e fermave të tyre dhe mbetjet bimore.



Përparësitë

- Përfitim i drejtpërdrejtë për individin;
- Reduktim i mbetjeve që ul ndotjen e ajrit dhe tokës;
- Prodhim i plehut natyral dhe cilësor për kopshte, bimë shtëpie dhe lulishte;
- Kosto e ulët fillestare pasi është metodë e thjeshtë për kompostim.

Disavantazhet

- Erërat e pakëndshme;
- Keqmenaxhimi mund të tërheqë insekte si miza dhe buburreca apo edhe kafshë si minjtë;
- Mungesa e hapësirave të posaçme për kompostim;
- Për personat që kanë pak kohë në dispozicion mund të jetë sfiduese pasi kërkon kohë dhe angazhim.

Kompostimi në komunitet

Në këtë model, një grup individësh, lagje, ose organizata lokale krijojnë një hapësirë të përbashkët për të mbledhur dhe kompostuar mbetje organike. Kjo qasje shpesh përfshin bashkëpunimin e një pjese të komunitetit dhe mund të përdoret për të prodhuar pleh për kopshtet e komunitetit. Kjo kërkon që të krijohet një grup drejtues i cili do jetë më përgjegjës për mbarrëvajtjen dhe menaxhimin e kësaj hapësire. Më pas është shumë e rëndësishme zgjedhja e një vendodhje të përshtatshme e cila është e arritshme për banorët por dhe mjaftueshëm larg për të minimizuar shqetësimet. Gjithashtu është shumë e nevojshme të përcaktohen rregulla të qarta për llojet e materialeve që mund të shtohen si dhe procedurat e mirëmbajtjes.



Përparësitë

- Përfshin një pjesë të madhe të anëtarëve të komunitetit;
- Nxiti ndjenjën e bashkëpunimit mes banorëve;
- Rrit ndërgjegjësimin për mjedisin;
- Ul sasinë e mbeturinave të prodhuara.

Disavantazhet

- Kërkon koordinim dhe angazhim të anëtarëve të komunitetit;
- Kërkon menaxhim dhe mirëmbajtje të përbashkët;
- Ka shumë rrezik për ndotje të plehut nëse mbetjet nuk klasifikohen siç duhen;
- Ka rrezik për tërheqjen e kafshëve dhe insekteve të padëshiruara;
- Ka nevojë për rregulla të qarta e zbatim të procedurave të mirëmbajtjes.

Kompostimi në biznese dhe institucione

Kompostimi në biznese dhe institucione është një mënyrë efektive për të menaxhuar mbeturinat organike në shkallë të gjerë, duke ndihmuar në reduktimin e ndikimit mjedisor dhe kursimin e burimeve. Ky model përfshin kompostimin e mbetjeve organike nga restorantet, kafenetë, shkollat dhe institucionet e tjera. Kompostimi bëhet brenda ndërtesave të këtyre institucioneve, ku mbetjet organike mbledhen dhe përpunohen në pajisje të posaçme për kompostim. Ky proces ka potencialin të kthehet në një praktikë të qëndrueshme dhe të dobishme për komunitetin dhe mjedisin.



- Redukton mbeturinat komerciale;
- Plehu i prodhuar mund të përdoret për bimët dekorative të biznesit;
- Kompostimi nxit punonjësit të përfshihen në qëndrueshmërinë mjedisore dhe edukohen mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit;
- Ka përfitime ekonomike për institucionet që përdorin plehun organik në kopshtet ose hapësirat e tyre të gjelbërta.

Përparësitë

Disavantazhet

- Kërkon investim në pajisje dhe në hapësira të cilat mund të kenë kosto të larta për disa institucione dhe biznese të vogla;
- Ka nevojë për mirëmbajtje dhe monitorim të rregullt;
- Bizneset dhe institucionet duhet të trajnojnë stafin për ndarjen e mbeturinave dhe procedurat e kompostimit;



Barrierat e kompostimit organik në komunitet

Edhe pse kompostimi organik në komunitet ka përfitime të mëdha për mjedisin dhe shëndetin e tokës, ka disa barrierat që pengojnë zbatimin dhe suksesin e tij. Këto barrierat mund të jenë teknike, sociale, financiare dhe edukative, si më poshtë:



Mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit



Infrastruktura e pamjaftueshme



Shqetësimet mbi erën dhe higjienën



Pengesa financiare



Mungesa e mbështetjes politike dhe ligjore



Rezistenca e komunitetit dhe kultura



Mungesa e edukimit dhe ndërgjegjësimit

Mungesa e njohurive dhe e ndërgjegjësimit për kompostimin organik është thelbësore që kompostimi organik të mos kryhet në komunitet. Më specifikisht:

- *Njohuri të pamjaftueshme për procesin e kompostimit.* Shumica e njerëzve nuk kanë informacion për materialet që mund të kompostohen, mënyrën e krijimit të një pirlu kompostimi dhe menaxhimin e kushteve të nevojshme (p.sh., lagështia dhe ajrosja). Pa këto njohuri, individët janë më të prirur të hezitojnë ose të shmangin kompostimin.
- *Mungesa e kuptimit për përfitimet mjedisore dhe ekonomike.* Individët nuk e shohin nevojën për t'u angazhuar në kompostim nëse nuk janë të informuar mbi përfitimet e kompostimit, si reduktimi i mbetjeve, përmirësimi i cilësisë së tokës dhe ulja e shpenzimeve për pleh kimik.
- *Kostot dhe burimet.* Mungesa e edukimit mund të krijojë frikë nga kostot të lidhura me kompostimin, si blerja e materialeve të nevojshme për ndërtimin e një sistemi kompostimi. Nëse njerëzit nuk dinë se si të krijojnë një sistem të thjeshtë dhe pa shumë kosto, ata mund të mos angazhohen.
- *Stigma dhe keqkuptime.* Edukimi i pamjaftueshëm mbi perceptimet negative si erërat e pakëndshme ose tërheqja e insekteve çon në keqkuptime që e pengojnë pranimin e kompostimit në komunitet. Informimi mbi mënyrat për të menaxhuar këto aspekte është i rëndësishëm për të ndihmuar në zbutjen e këtyre frikërave.
- *Mungesa e modelit të mirë.* Nëse nuk ka shembuj të suksesit ose grupe të organizuara që promovojnë kompostimin, individët mund të ndihen të pavendosur për ta filluar këtë proces.
- *Kultura e komunitetit.* Nëse kompostimi nuk është pjesë e kulturës lokale ose nuk njihet si një praktikë e pranueshme, individët mund të ndihen të pashpresë për të filluar kompostimin. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i duhur mund të ndihmojnë në ndërrimin e kulturës së komunitetit.
- *Qasja në burime edukative.* Mungesa e burimeve të edukimit, si punëtori, trajnime dhe materiale informative, e bën më të vështirë për individët të mësojnë rreth kompostimit. Ofrimi i mundësive për të mësuar është thelbësor për të tejkaluar këtë barrierë.
- *Inkurajimi i pjesëmarrjes në iniciativë lokale.* Iniciativa lokale që promovon kompostimin, si grupe komuniteti apo aktivitete në shkollë, mund të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit.

Zgjidhje Për të tejkaluar këto barrierë, është e nevojshme të implementohen strategji edukative dhe informuese, të organizohen fushata ndërgjegjësimi dhe të krijohen mundësi për trajnime praktike. Kjo do të ndihmojë në rritjen e interesit dhe angazhimit për kompostimin organik, duke kontribuar kështu në një komunitet më të qëndrueshëm.



Infrastruktura e pamjaftueshme

Mungesa e infrastrukturës së duhur për kompostimin është një barrierë e rëndësishme që ndikon në efikasitetin e praktikave të kompostimit organik në komunitet. Kjo mungesë ka disa implikime dhe pasoja që ndihmojnë në shpjegimin e sfidave të hasura. Ja disa aspekte kryesore:

- *Hapësira të pamjaftueshme për kompostim.* Shumë individë dhe familje nuk kanë hapësira të mjaftueshme në oborret e tyre për të krijuar një sistem kompostimi. Mungesa e hapësirave të përshtatshme ndikon në mundësinë e tyre për t'u angazhuar në kompostim.
- *Mungesa e infrastrukturës publike.* Në shumë komunitete, nuk ka vende të dedikuara për kompostimin, siç janë pikat e grumbullimit për kompostim që ndihmojnë në mbledhjen e mbetjeve organike. Një gjë e tillë nuk u jep mundësi atyre individëve që kanë dëshirë të kompostojnë por që nuk mund të kompostojnë në shtëpi.
- *Mungesa e pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme.* Kompostimi efikas kërkon mjete të veçanta, si sharra, lopata dhe kontenierë kompostimi. Pa qasje në këto mjete, individët kanë më shumë vështirësi për të menaxhuar procesin e kompostimit.
- *Kufizime të shërbimeve të transportit.* Mungesa e shërbimeve të transportit për të mbledhur mbetjet organike dhe për t'i çuar në vendet e kompostimit e bën të vështirë për individët që të angazhohen në kompostim.
- *Pamundësia për menaxhimin e kushteve të kompostimit.* Një infrastrukturë e dobët pengon individët në menaxhimin e kushteve të nevojshme për kompostim, si ajrosja, lagështia dhe temperatura e duhur. Kjo mund të çojë në probleme si erëra të këqija dhe mbledhja e insekteve.
- *Mungesa e mbështetjes institucionale.* Pa mbështetje nga autoritetet lokale, si ndihmë teknike dhe burime, është e vështirë për komunitetet të krijojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën e nevojshme për kompostimin. Kjo përfshin mungesën e planeve dhe strategjive të qarta për të mbështetur praktikën e qëndrueshme.
- *Mungesa e informacionit dhe ndihmës teknike.* Mungesa e informacionit dhe e ndihmës teknike mbi ndërtimin e infrastrukturës së kompostimit paraqet një barrierë.

Zgjidhje Për të adresuar këto sfida, është e nevojshme që komunitetet të investojnë në infrastrukturën e duhur për kompostimin. Kjo mund të përfshijë:

- **Krijimin e hapësirave të dedikuara për kompostim** në zona publike.
- **Ofrimin e trajnimeve dhe burimeve** për individët mbi ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kompostimit.
- **Krijimin e shërbimeve të mbledhjes** së mbetjeve organike nga shtëpitë dhe bizneset.
- **Pjesëmarrja e autoriteteve lokale** në promovimin e praktikave të kompostimit dhe ofrimin e mbështetjes teknike.



Shqetësimet mbi erën dhe higjienën

Shqetësimet për erën dhe higjienën janë barriera të rëndësishme që pengojnë kompostimin organik në komunitet. Frika se kompostimi mund të krijojë erëra të pakëndshme dhe tërheqje insektesh i bën njerëzit të hezitojnë për ta zbatuar atë, sidomos në zonat urbane dhe me densitet të lartë banimi. Ja disa mënyra se si këto shqetësime ndikojnë dhe çfarë mund të bëhet për t'i adresuar ato:

- *Frika nga erërat e pakëndshme.* Një nga shqetësimet më të zakonshme është frika se kompostimi do të prodhojë erëra të pakëndshme. Kjo është e zakonshme në rastet kur kompostimi nuk menaxhohet si duhet (p.sh., përzierje e papërshtatshme e materialeve ose mungesa e ajrosjes).
- *Ndikimi në higjienë dhe shëndet publik.* Shqetësimet për higjienën lidhen me perceptimin se kompostimi mund të tërheqë brejtës dhe insekte, të cilat lidhen me probleme të higjienës dhe rrezik për sëmundje. Nëse kompostimi nuk bëhet në mënyrë të saktë, mbeturinat organike mund të kontribuojnë në përhapjen e mikrobeve dhe të shkaktojnë ndotje të mjedisit rrethues.
- *Perceptimi i mungesës së kontrollit të kompostit.* Shumë njerëz nuk janë të njohur me teknikat e kompostimit dhe si rrjedhojë kanë perceptimin se procesi nuk mund të kontrollohet duke bërë që mbetjet të kalben në vend të dekompozohen. Pa informacion dhe trajnime të përshtatshme, ky perceptim mund të frenojë individët për të marrë pjesë në kompostim.
- *Shqetësimi për shëndetin e fëmijëve dhe kafshëve shtëpiake.* Për familjet me fëmijë të vegjël dhe kafshë shtëpiake, kompostimi mund të ngjallë shqetësime mbi sigurinë, pasi mund të përmbajë elementë që nuk janë të shëndetshëm për ta.
- *Pamundësia për të menaxhuar kushtet e duhura për kompostim.* Pa njohuritë e nevojshme për menaxhimin e kushteve të kompostimit, si përzierja e saktë e materialeve "të gjelbra" (të lagështa) dhe "të kafe" (të thata) ose mbajtja e lagështisë në nivelin e duhur, procesi mund të bëhet problematik duke prodhuar erëra të pakëndshme.

Zgjidhje

-Edukimi mbi menaxhimin e kompostit, përzierjen e materialeve dhe ajrosjen e mjaftueshme mund të ndihmojë në zvogëlimin e erërave dhe në ruajtjen e higjienës. Trajnimet mund të përfshijnë teknika si mbajtja e lagështisë së duhur dhe rrotullimi i kompostit.

-Përdorimi i kontenierëve të mbyllur për kompostimin ndihmon në mbajtjen e erërave brenda dhe në parandalimin e hyrjes së kafshëve apo insekteve. Këta kontenierë janë të përshtatshëm për zonat urbane dhe për komunitete me densitet të lartë banimi.

-Vendosja e kompostit larg zonave të zakonshme të banuara ose afër kufijve të oborrit ndihmon në minimizimin e ndikimit të mundshëm tek fqinjët.

-Mbulimi i materialeve të lagështa me materiale të thata, si kashtë ose karton, ndihmon në reduktimin e erërave dhe tërheqjes së insekteve. Kjo teknikë thjeshtëson menaxhimin dhe mban kompostin të pastër dhe të freskët.

-Për ata që nuk kanë hapësira private ose kanë shqetësime për higjienën, **kompostimi në qendrat e dedikuara për kompostim të përbashkët** ndihmon në uljen e këtyre barrierave, duke u mundësuar individëve të kontribuojnë në mënyrë të organizuar.



Pengesa financiare

Pengesat financiare përbëjnë një sfidë të madhe për kompostimin organik në komunitet, veçanërisht në komunitetet ku burimet financiare janë të kufizuara. Mungesa e fondeve dhe kostot fillestare të kompostimit mund të pengojnë zbatimin e kësaj praktike edhe pse është e dobishme për mjedisin. Ja disa mënyra se si këto pengesa financiare ndikojnë në procesin e kompostimit:

- *Kostoja e pajisjeve të nevojshme.* Fillimi i kompostimit shpesh kërkon pajisje specifike, si kontenerë të mbyllur, sharra dhe mjete të tjera për përpunimin e materialeve organike. Këto pajisje kanë një kosto fillestare që mund të jetë pengesë për individët ose komunitetet me buxhet të kufizuar.
- *Mungesa e parave për mirëmbajtje.* Përveç kostove fillestare, kompostimi kërkon edhe mirëmbajtje të vazhdueshme, që përfshin kontrollimin e lagështisë, ventilimit dhe ndonjëherë blerjen e materialeve të tjera plotësuese.
- *Kosto e trajnimit dhe edukimit.* Për një kompostim të suksesshëm, individët dhe grupet kanë nevojë për trajnime mbi praktikën e duhura dhe menaxhimin e kompostit. Këto trajnime shpesh kanë një kosto, qoftë për sigurimin e materialeve edukative apo për mbajtjen e kurseve.
- *Pamundësia për infrastrukturë të dedikuar.* Nëse komuniteti vendos të krijojë zona të përbashkëta kompostimi, duhen fonde për të ndërtuar ose përshtatur një hapësirë të dedikuar për këtë proces. Kjo mund të përfshijë kosto për ndërtim apo transport të mbetjeve organike.
- *Mungesa e mbështetjes financiare nga autoritetet lokale.* Në shumë raste, autoritetet lokale ose shtetërore nuk ofrojnë subvencione ose financim për iniciativat e kompostimit, duke e bërë të vështirë për komunitetet që të fillojnë dhe të mirëmbajnë kompostimin. Pa mbështetje financiare nga qeveritë lokale, iniciativat mbeten të varura vetëm nga buxheti i banorëve.
- *Kostoja e transportit për materialet organike.* Për individët që nuk kanë hapësirë për kompostim në shtëpi, transporti i mbetjeve në një qendër kompostimi kërkon kosto të vazhdueshme. Për disa, mund të jetë më i lehtë të hedhin mbeturinat në vend të kompostimit për shkak të këtyre kostove.

Zgjidhje Me planifikim të duhur dhe mbështetje financiare nga burime të ndryshme, barrierat ekonomike për kompostimin mund të kapërcehen, duke i dhënë mundësinë çdo komuniteti të kontribuojë në reduktimin e mbetjeve dhe në përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Disa strategji mund të përfshijnë:

- Ofrimi i **subvencioneve/grantet nga autoritetet lokale** për kompostimin mund të ndihmojnë komunitetet të mbulojnë kostot fillestare dhe të vazhdueshme.
- Duke krijuar **zona të përbashkëta kompostimi** në bashkëpunim me autoritetet lokale, komuniteti mund të ndajnë burimet dhe të zvogëlojnë koston për individët.
- Organizatat jofitimprurëse dhe ato për mbrojtjen e mjedisit mund të ofrojnë **trajnime dhe materiale edukative falas** duke ndihmuar individët.



Mungesa e mbështetjes politike dhe ligjore

Në shumë vende, mungesa e politikave dhe ligjeve mbështetëse për kompostimin organik është një pengesë. Pa rregullore që detyrojnë ndarjen e mbetjeve organike ose inkurajojnë kompostimin në nivel komunitar, vullneti i individëve për të marrë pjesë në proces mund të jetë i ulët.

Shkaktarë: Politika të pamjaftueshme për kompostim, prioritetet e ulëta për menaxhimin e mbetjeve organike.

Zgjidhje: Krijimi i rregulloreve për ndarjen e mbetjeve organike, politika që inkurajojnë kompostimin në komunitet dhe përfitime fiskale për individët që marrin pjesë në programe kompostimi.



Përzierja e mbetjeve dhe ndërtimi i sistemit të ndarjes

Një tjetër barrierë është përzierja e mbetjeve organike me ato të papërpunueshme si plastikë, metale ose qelq. Mungesa e sistemeve të organizuara të ndarjes së mbetjeve e vështirëson menaxhimin e suksesshëm të kompostimit në komunitet.

Shkaktarë: Ndarje e pamjaftueshme e mbetjeve në burim, mungesa e kontejnerëve të veçantë për mbetje organike.

Zgjidhje: Implementimi i programeve të ndarjes së mbetjeve, edukimi i komunitetit për rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim, ofrimi i infrastrukturës për grumbullimin e mbetjeve organike.



Rezistenca e komunitetit dhe kultura

Në disa raste, komunitetet mund të jenë rezistente ndaj ndryshimeve, sidomos kur kompostimi shihet si i ndërlikuar ose jo i rëndësishëm. Faktorët kulturorë dhe perceptimet e publikut mund të ndikojnë në gatishmërinë e njerëzve për t'u përfshirë ose jo në proces. Prandaj, ndryshimi i qëndrimeve të komunitetit dhe kapërcimi i barrierave kulturore kërkon edukim, angazhim dhe mbështetje të përbashkët nga liderët lokalë dhe komunitetet. Me strategji të drejtuara dhe përpjekje për ndërgjegjësim, kompostimi mund të shihet si një praktikë e vlefshme dhe e arritshme për të gjithë, duke promovuar një mjedis më të shëndetshëm dhe një komunitet të qëndrueshëm.

Mësimet e nxjerra nga kompostimi organik në komunitet

Kompostimi organik në komunitet ka rezultuar në shumë përfitime për qëndrueshmërinë dhe shëndetin mjedisor. Gjatë zbatimit të këtyre programeve, komunitetet dhe organizatat kanë nxjerrë disa mësimet të rëndësishme që ndihmojnë në përmirësimin e modeleve dhe në tejkalimin e sfidave. Disa prej mësimëve kryesore përfshijnë aspektet e edukimit, përfshirjes, teknologjisë, dhe mbështetjes institucionale siç edhe shpjegohen në vijim.





Edukimi dhe ndërgjegjësimi janë kyç për suksesin

Një nga mësimet më të rëndësishme të nxjerra është rëndësia e edukimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit mbi kompostimin organik. Programet e kompostimit kanë qenë më të suksesshme kur individët janë trajnuar dhe informuar për procesin e kompostimit, llojet e mbetjeve që mund të kompostohen dhe përfitimet që sjell ky proces. Ndaj është e rëndësishme që edukimi i komunitetit të kryhet para se të fillohet procesi i fillimit të kompostimit në komunitet dhe të vijojë në mënyrë periodike edhe pas fillimit të këtij procesi duke u fokusuar kryesisht në parandalimin e gabimeve në procesin e kompostimit, si përzjerja e mbetjeve të papërshtatshme, modelet e kompostimit dhe mirëmbajtja e tij. Ky edukim mund të kryhet përmes organizimit të seminareve të ndryshme, fushatave publike ndërgjegjëse, dhe demonstrimeve praktike për të nxitur ndërgjegjësimin për kompostimin organik.



Mbështetja nga liderët lokalë dhe organizatat është thelbësore

Mbështetja dhe përfshirja e liderëve të komunitetit, organizatave joqeveritare dhe institucioneve lokale ka rezultuar vendimtare për suksesin e kompostimit organik në komunitete. Pa mbështetje nga liderët lokalë, përpjekjet për kompostim shpesh nuk gjejnë mbështetje të gjerë nga i gjithë komuniteti apo burimet e nevojshme për të pasur sa më shumë sukses. Bashkëpunimi me këto aktorë ndihmon gjithashtu në ndërtimin e infrastrukturës dhe krijimin e politikave mbështetëse ndaj nismave të tilla.



Përfshirja e komunitetit është e rëndësishme për qëndrueshmëri

Projekte që kanë përfshirë komunitetin në çdo hap të procesit, nga planifikimi deri te zbatimi dhe monitorimi, kanë treguar qëndrueshmëri më të lartë dhe sukses më të lartë në arritjen e objektivave. Përfshirja aktive e vetë komunitetit përmirëson ndjenjën e pronësisë dhe përgjegjësisë përmes organizimit të diskutimeve publike, mbledhjeve të anëtarëve të komunitetit dhe grupeve të punës për të marrë pjesëmarrje sa më aktive nga banorët. Sa më shumë i përfshirë të jetë komuniteti në të gjithë hapat e zbatimit të procesit të kompostimit aq më shumë qëndrueshmëri dhe sukses do të ketë ai.



Infrastrukturat dhe pajisjet e duhura janë thelbësore

Komunitetet që kanë investuar në infrastrukturë dhe pajisje të përshtatshme për kompostim (si kontejnerët e mbyllur, sistemet për ndarjen e mbetjeve organike) kanë patur rezultate më të mira. Një infrastrukturë e mirë e thjeshton procesin dhe rrit efikasitetin e kompostimit.



Politikat mbështetëse dhe ligjet e komunitetit ndihmojnë suksesin

Në komunitetet ku janë krijuar politika mbështetëse dhe ligje që nxisin ndarjen e mbetjeve organike dhe kompostimin, përpjekjet kanë qenë më të suksesshme. Ligjet që detyrojnë ose nxisin individët dhe bizneset të ndajnë mbetjet organike kanë ndihmuar në zbatimin me sukses të skemave të kompostimit organik në komunitet.



Vëmendja ndaj higjienës dhe kontrollit të erërave është e nevojshme

Një mësim i rëndësishëm është rëndësia e kontrollit të erës dhe higjienës në kompostimin komunitar, veçanërisht në zonat urbane. Komunitetet që nuk i kanë kushtuar vëmendje këtij aspekti kanë hasur probleme me rezistencën e banorëve ndaj kompostimit. Prandaj, përdorimi i teknikave si kompostimi i mbyllur dhe ndarja e mbetjeve organike nga mbeturinat e tjera për të reduktuar erërat dhe për të mbajtur pastërtinë mbetet thelbësore për menaxhimin e duhur të erës dhe mbajtja e higjienës është e domosdoshme për pranimin dhe qëndrueshmërinë e kompostimit organik në komunitet.



Monitorimi dhe përmirësimi i procesit ndihmon në përmirësimin e rezultateve

Komunitetet që kanë zbatuar sisteme për monitorimin dhe matjen e rezultateve të kompostimit kanë qenë më të afta të identifikojnë problemet dhe të përmirësojnë procesin. Monitorimi ndihmon në parandalimin e gabimeve dhe në përmirësimin e efikasitetit. Në këtë aspekt është e rëndësishme krijimi i grupeve monitoruese për të mbikëqyrur dhe analizuar progresin e programeve të kompostimit, si dhe për të ofruar përmirësime të vazhdueshme gjë që do të ndihmojë në rregullimin e metodave dhe përmirësimin e cilësisë së kompostit.

Si përfundim,

Kompostimi organik në komunitet ka sjellë shumë mësim të vlefshme që ndihmojnë në përmirësimin e modeleve të qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve organike. Duke investuar në edukim, infrastrukturë dhe duke përfshirë në mënyrë aktive komunitetin, këto programe mund të jenë të qëndrueshme dhe të suksesshme. Zbatimi i mësimave të mësuara ndihmon në zbutjen e pengesave për zbatimin e skemave të suksesshme të kompostimit organik në komunitet dhe rritjen e përfitimeve afatgjata për mjedisin dhe shoqërinë.

Kompostimi organik sjell përfitime të shumta mjedisore, si reduktimi i mbetjeve që përfundojnë në landfille dhe ulja e emetimeve të gazrave serë. Përveç kësaj, krijon lëndë ushqyese të pasura për tokën, që përmirësojnë pjellorinë dhe shëndetin e bimëve lokale. Përfshirja e komunitetit në këtë proces i bën njerëzit më të ndërgjegjshëm për ndikimin e mbetjeve të tyre dhe i motivon ata të adoptojnë zakone më të qëndrueshme në jetën e përditshme.

Në tërësi, këto programe fuqizojnë komunitetet dhe i bëjnë ato më të lidhura e të angazhuara për mbrojtjen e mjedisit, duke krijuar një cikël pozitiv që përfiton gjenerata e ardhshme. Kompostimi organik promovon gjithashtu solidaritetin mes banorëve, duke krijuar hapësira për bashkëpunim dhe shkëmbim njohurish mbi praktikën e gjelbra. Përveç përfitimeve mjedisore dhe ekonomike, këto nisma forcojnë ndjenjën e përkatësisë dhe përgjegjësisë kolektive ndaj natyrës.



Praktikat e mira të kompostimit organik në komunitet.

Kompostimi organik në komunitet është një mënyrë e shkëlqyer për të trajtuar mbeturinat organike, reduktuar mbetjet e dërguara në landfill, dhe për të prodhuar pleh të pasur për feramat, kopshtet dhe hapësirat e gjelbra. Për të siguruar suksesin dhe qëndrueshmërinë e programeve të kompostimit në komunitet, disa praktika të mira janë zhvilluar në bazë të përvojave të ndryshme globale dhe lokale.

Më poshtë janë disa nga praktikat më të mira që ndihmojnë në arritjen e kompostimit efektiv, të evidentuara në zbatimin e projektit “Shtrirje e kompostimit organik në komunitetet rurale” zbatuar në fshatrat e njësive administrative Bërzhitë dhe Zall-Herr të Bashkisë Tiranë.



Disa nga praktikat e mira të nxjerra gjatë zbatimit të projektit janë si më poshtë:

- a. Përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit;
- b. Trajnim praktik dhe demonstrime në terren;
- c. Mësimi nga përvijat e njëri-tjetrit;
- d. Edukimi në shkollë dhe përfshirja e fëmijëve;
- e. Monitorimi afatgjatë dhe mbështetja pas projektit.

a. Përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit

Projekti përfshiu aktivisht anëtarët e komunitetit përmes punëtorive dhe takimeve informuese, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësitimit mbi përfitimet e kompostimit organik, si përmirësimi i cilësisë së tokës dhe reduktimin e mbetjeve të dërguara në landfillë. Liderët lokalë, të cilët ishin të respektuar dhe të besuar nga komuniteti, luajtën një rol kyç në krijimin e besimit dhe promovimin e kompostimit si praktikë të re dhe të dobishme për mjedisin dhe ekonominë.

b. Trajnim praktik dhe demonstrime në terren

Përmes trajnimeve praktike, fermerët patën mundësinë të mësonin drejtpërdrejt se si funksionon procesi i kompostimit dhe si të përdorin me sukses teknika të ndryshme për të kthyer mbetjet organike në pleh natyror. Demonstrimet praktike të realizuara gjatë vizitave në terren, u kanë dhënë fermerëve njohuri të qarta dhe të prekshme për përfitimet e kompostimit dhe mënyrat se si mund ta përmirësojnë prodhimin e tokës së tyre pa përdorimin e plehrave kimike.

c. Mësimi nga përvojat e njëri-tjetrit

Fermerët që kishin përvojë dhe rezultate pozitive nga kompostimi ndanë historitë dhe teknikat e tyre me të tjerët, veçanërisht duke i ndihmuar në përballimin e sfidave të zakonshme, siç janë menaxhimi i aromave të pakëndshme dhe balancimi i materialeve të kompostit. Ky model i mësimi me bazë në komunitet dhe përvojë personale nxiti pjesëmarrjen dhe besimin tek të tjerët që të aplikojnë këto metoda në fermat dhe kopshtet e tyre.

d. Edukimi në shkolla dhe përfshirja e fëmijëve

Projekti përfshiu shkollat lokale, duke i angazhuar fëmijët në aktivitete edukative mbi rëndësinë e kompostimit dhe mbrojtjen e mjedisit. Fëmijët krijuan projekte artistike dhe mësuajnë praktikën e kompostimit, të cilat i ndanë më pas me familjet e tyre. Kjo ndihmoi në përhapjen e kulturës së qëndrueshmërisë edhe nëpërmjet brezave të rinj, duke e kthyer kompostimin dhe kujdesin për mjedisin në një temë të përbashkët për familjet e tyre.

e. Monitorimi afatgjatë dhe mbështetja pas projektit

Vizitat e rregullta nga stafi i projektit ndihmuan që praktikën e kompostimit të vazhdonin edhe pasi projekti fillestar kishte përfunduar, duke adresuar sfidat e ndryshme që fermerët hasën gjatë procesit. Përmes monitorimit të vazhdueshëm, fermerët u ndihmuan të përmirësojnë teknikat e tyre dhe të arrijnë rezultate më të mira, duke krijuar kështu një impakt të qëndrueshëm në menaxhimin e mbetjeve dhe përmirësimin e tokës.

Histori sukcesi...

Rrugëtimi i Ilirit: Një nga fermerët, Iliri, ndau përvojën e tij për fillimin e kompostimit, ku fillimisht kishte dyshime për dobinë e tij. Mirëpo, me kalimin e kohës, ai pa përfitime dhe e përfshiu kompostimin si pjesë të përditshme të punës së tij në fermë. Iliri u shpreh: "Ky projekt na ka kujtuar që çdo hap i vogël ka rëndësi të madhe. Kthimi i mbetjeve në diçka të vlefshme është diçka që nuk e kam imagjinuar më parë, por sot është pjesë e rutinës sime të përditshme." Përvoja e tij inkurajoi fermerët e tjerë në komunitet që të ndjekin këtë shembull dhe të përfshihen në projekt.

Rasimi u shpreh: "Gjithçka filloi si një përpjekje për të përmirësuar bujqësinë time përmes kompostimit, por shumë shpejt u përballa me sfidën e balancimit të materialeve jeshile dhe kafe. Me ndihmën e komunitetit, mësova teknika të reja dhe fillova të ndaj përvojat e mia me të tjerët. Sot, komposti im prodhon humus cilësor që ka rigjallëruar tokën dhe përmirësuar të korrat. Më e rëndësishmja, kjo përvojë na ka bashkuar si komunitet, duke forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin mes nesh."

Sadetja tregon: "Për vite me radhë isha e varur nga plehurat kimike për të mbajtur kopshtin tim të vogël, një barrë për buxhetin e shtëpisë dhe për tokën. Gjithçka ndryshoi kur u bashkova tek projekti, ku mësova si të kompostoja mbetjet organike të përditshme. Sot, kopshti im lulëzon falë humusit të krijuar nga këto mbetje, duke përmirësuar jo vetëm tokën, por edhe ekonominë familjare. Kjo përvojë më tregoi se fuqizimi i grave dhe ndarja e njohurive mund të sjellin ndryshime të mëdha në jetën tonë dhe në komunitet."



Referencat

1. Studime Shkencore dhe Artikuj Akademikë

- Haug, R. T. (1993). The Practical Handbook of Compost Engineering. Lewis Publishers. Ky libër ofron njohuri të thelluara për proceset teknike të kompostimit dhe është një burim bazë për metodat e menaxhimit të mbetjeve organike.
- Gajalakshmi, S., & Abbasi, S. A. (2008). Solid Waste Management by Composting: State of the Art. Critical Reviews in Environmental Science and Technology. Ky artikull shqyrton përfitimet dhe sfidat e kompostimit si një metodë e qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve.

2. Udhëzues Ndërkombëtarë për Kompostimin

- Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO). (2020). Guidelines on Composting for Sustainable Agriculture. Ky udhëzues trajton teknikat e kompostimit në kontekstin e qëndrueshmërisë dhe ndikimin pozitiv të tij në bujqësi.
- Komisioni Evropian. (2021). Circular Economy and Organic Waste Management: A Policy Framework. Ky dokument mbulon politikat dhe strategjitë e BE-së për promovimin e ekonomisë qarkulluese përmes kompostimit.

3. Praktika dhe Manualë nga Organizata Jofitimprurëse

- Global Composting Alliance. (2023). Community Composting Manual. Manuali ofron një udhëzues praktik për kompostimin komunitar, duke përfshirë teknikat e menaxhimit dhe organizimit të kompostit në shkallë të vogël dhe të madhe.
- Green Line Albania. (2022). Sustainable Waste Management Practices in Albania. Raporti fokusohet në praktikat e qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve organike dhe përfshirjen e komunitetit.

4. Burime Vendore dhe Plane Strategjike

- Bashkia Tiranë. (2024). Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Kjo strategji përfshin nisma për promovimin e kompostimit në zonat urbane dhe rurale si një zgjidhje për menaxhimin e mbetjeve organike.
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Shqipëri. (2023). Raporti mbi Iniciativat për Menaxhimin e Mbetjeve Organike. Ky dokument analizon progresin dhe sfidat e implementimit të projekteve të kompostimit në Shqipëri.

5. Burime Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Publik

- Ekolëvizja. (2022). Fushata Edukative për Kompostimin në Shqipëri. Materialet e fushatës përfshijnë udhëzime për edukimin e komunitetit mbi përfitimet dhe metodat e kompostimit organik.
- Earth Day Network. (2021). Composting for a Greener Future. Ky raport përmban strategji për ndërgjegjësimin publik dhe promovimin e praktikave të kompostimit gjatë eventeve si "Dita e Tokës".
- Ministria e Mjedisit, Shqipëri. Kompostoni! Është mirë për ju, është mirë për natyrën. Ky dokument përmban disa këshilla të dobishme për kompostimin, mënyrat e ndryshme të kompostimit, përzierjen e materialeve të ndryshme të përdorshme për kompostim dhe këshilla mbi materialet që nuk duhet të kompostohen.

Referencat

Literatura Plotësuese

1. Libra dhe Manualë Praktikë

- Rynk, R. (1992). On-Farm Composting Handbook. Northeast Regional Agricultural Engineering Service. Ky manual ofron udhëzime praktike për kompostimin në ferma dhe përfshin teknika të ndryshme për përmirësimin e procesit të kompostimit.
- Epstein, E. (2011). Industrial Composting: Environmental Engineering and Facilities Management. CRC Press. Libri përqendrohet në kompostimin industrial, me një theks të veçantë në menaxhimin e impianteve të mëdha të kompostimit dhe ndikimet mjedisore.

2. Artikuj Shkencorë

- Tiquia, S. M., & Tam, N. F. Y. (2002). Characterization and Composting of Poultry Litter in Forced-Aeration Piles. Process Biochemistry, 37(8), 869-880. Ky studim analizon një metodë specifike të kompostimit duke përdorur pleh organik dhe përfshin rezultatet mbi përbërjen e kompostit.
- Bernal, M. P., Alburquerque, J. A., & Moral, R. (2009). Composting of Animal Manures and Chemical Criteria for Compost Maturity Evaluation: A Review. Bioresource Technology, 100(22), 5444-5453. Ky artikull shqyrton kriteret për vlerësimin e maturitetit të kompostit dhe metodat e kompostimit të mbetjeve bimore dhe shtazore.

3. Burime nga Organiza Ndërkombëtare dhe Publikime të BE-së

- European Environment Agency (EEA). (2022). Bio-Waste in Europe: Turning Challenges into Opportunities. Ky raport i EEA analizon praktikat e menaxhimit të mbetjeve organike në vende të ndryshme të BE-së dhe përfshin rekomandime për zbatimin e kompostimit në nivel komuniteti.
- UNEP (United Nations Environment Programme). (2021). Guidelines for Organic Waste Management and Composting Strategies. Publikimi përfshin udhëzime për menaxhimin e mbetjeve organike dhe praktika të mira për kompostimin në nivel lokal dhe rajonal.

4. Manualë dhe Udhëzues për Edukimin e Komunitetit

- The Rodale Book of Composting (Rodale Institute, 1992). A Simple Guide to Making Soil for Your Garden. Ky libër është një udhëzues i plotë për kompostimin në shtëpi dhe komunitet, me theks në teknikat e thjeshta dhe të përbalueshme.
- Composting Council Research & Education Foundation (CCREF). (2020). Community Composting Done Right: A Comprehensive Guide. Manuali përmban teknika të detajuara për kompostimin në nivel komuniteti dhe përfshin shembuj praktikë nga projekte të suksesshme në Amerikën e Veriut.

5. Raporte dhe Projekte të Suksesshme

- Zero Waste Europe (2023). Best Practices in Community Composting. Raporti përfshin raste suksesi dhe analiza të projekteve të kompostimit në qytete të ndryshme evropiane, duke u fokusuar në përfshirjen e komunitetit dhe ndikimin mjedisor pozitiv.
- WRAP (Waste and Resources Action Programme). (2022). Home and Community Composting Guide. Ky raport përfshin udhëzime për kompostimin në shkallë të vogël dhe përfshin studime rasti nga projekte në Mbretërinë e Bashkuar.



© **Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V** Zyra për Shqipërinë
Kompleksi Kika 2, Rruga Tish Daija, Nd. 1C9, H.9, Ap.7A, 1020 Tiranë - Shqipëri

Email: info-alb@help-ev.de

Cel: +355 69 572 6762

Website: www.help-albania.org

Facebook: Help in Albania

Instagram: Help in Albania

Linkedin: Help in Albania